Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

1. Të dhëna mbi shoqërinë

"HTM" SHPK është themeluar më 03.08.2009. Është regjistruar në QKR me NIPT K97006004D datë 6.8.2009.

Statusi juridik: Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

Kapitali aksionar 65,100,000 LEKE, i zotëruar nga ortaku i vetëm Ilir TABAKU.

Më 21.08.2019 me çështjen Nr. CN-307347-08-19 ortaku i vetëm i shoqërisë ka depozituar pranë QKB vendimine tij me datë 09.08.2019 dhe kontratën me të njëjtën datë, për zmadhimin e kapitalit me bashkimin e rezervave të tjera me vlerë 65,000,000.

Selia e entitetit ndodhet në Lagjjen Perash, Rr. Rrojej, Nr 44, Shkodër. Nuk është e organizuar në filiale apo degë.

Vend tjetër i ushtrimit të aktivitetit është:

- L. 1, Rr. Tregtare, pranë APD, pasuria, Durrës.
- L. 15, Rr. Miqësia, përballë kampusit të UAMD, pasuria 106/6, ZK 8517, Spitallë – Durrës.

Objekti i Veprimtarisë:

Import - eksport, projektime dhe zbatime në fushën elektrike.Tregtim të artikujve të ndryshëm. Çertifikim personeli sipas Standardit EN ISO/ IEC 17024, për sigurimin teknik në fushën elektrike. Planifikimi,zhvillimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja, për vete dhe për të tretë të impianteve të energjisë së rinovueshme, centraleve në bazë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, të tilla si era, uji, biomasa, rrezatimi diellor dhe burime potenciale të tjera të energjisë. Tregtim, prodhim, montim dhe mirëmbajtje të moduleve fotovoltaike si dhe konstruksionet mbajtëse të tyre. Marrje në përdorim, me qera, koncensione apo forma të tjera, toka, objekte apo vepra të ndryshme nga subjekte private apo publike. Projektim në fushën e ndërtimit, infrastruktures,urbanistikës, mekanikës, ujësjellesave, gazsjellësave, dhe veprave të artit.
Punime gërmimi, ndërtimi, rikonstruksione dhe mirëmbajtje në objekte civile dhe industriale. Ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrugëve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvaj, metrove e pistave aeroportuale, rrjetat e ujësjellës-kanalizimeve. Instalim, shërbime dhe konsulencë të impianteve teknologjike, termike, hidrike, të ventilimit, ftohje-ngrohje (kondicionimit), furnizimit me gas, iimpianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), të sinjalistikës rrugore, të sistemeve të mbrojtjes ndaj zjarrit në objekte civile dhe industriale, impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, nënstacioneve elektrike, kabinat e transformatorëve, linjat e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarje të energjisë elektrike, automatizim/informatizim i proçeseve civile dhe industriale, impiante CCTV. Studime fizibiliteti në fushën e ushtrimit tëveprimtarisë së shoqërisë.

Të tjera, raportuar vullnetarisht: Tregti makineri e paisje, artikuj konsumi, detergjentë, elektroshtëpiake e material ndërtimi. Prodhim, botim dhe tregtim shtypshkrimesh. Tregtim dhe prerje xhamash. Hapje dyqane e lokale për restorante e bar bufe, hoteleri. Hapje agjensish imobiliare, detare, spedicionere, turistike, transport brenda dhe jashtë vendit (detar, tokësor dhe udhëtarësh). Hapje pika servis dhe lavazh. Punime në fushën e ndërtimeve.

Baza ligjore që rregullon venrimtarinë e shoqërisë është:

Statuti i shoqërisë;

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët Shoqëritë Tregtare";

Ligji "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

Akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit Shqiptar.

Drejtimi realizohet nga Asambleja cilësitë e të cilës i ushtron ortaku i vetëm dhe administratori,

Qarkullimi vjetor 359 824 (2018: 177 437) mijë LEKE (afarizmi)

Nr. mesatar i punonjësve ka qenë 39 (2018:22)

2. Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare (SKK 1)

a. Deklarata e përputhshmërisë dhe objektivi

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (Nr. 1-14), të përmirësuara, të shpallura nga Ministri i Financave me urdhërin Nr.64, datë 22.07.2014 në mbështetje të pikës 4 të ligjit Nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe të vendimit Nr. 1, datë 15.06.2014 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit "Për miratimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara". Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, të dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion (SKK1/5).

Kontabiliteti mbahet programin e kontabilitetit FINANCA, mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

b. Periudhat krahasimore dhe çelja

Të dhënat e periudhave të mëparshme janë të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore. Balancat e mbylljes më 31.12.2018 janë kontabilizuar saktë në çelje 01.01.2019

c. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proçesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhen në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Për vitin financiar 2019 shoqëria nuk ka bërë vlerësime kontabël me ndikim material në pasqyrat financiare.

2.1. Parimet bazë për përgaditjen e pasqyrave financiare

Supozime dhe konsiderata të përgjithshme

a. Konstatimi i të drejtave / detyrimeve dhe përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe jo kur arkëtohen (SKK 1/41 - 43).

b. Parimi i njësisë ekonomike

Njësia ekonomike mban llogari të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të veta të veçanta nga ato të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të aksionarëve, kreditorëve, punonjësve, klientëve si dhe personave të tjerë. Vetëm aktivet, detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike janë regjistruar në pasqyrat e saj financiare. (SKK 1/44-45).

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

2. Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare (SKK 1) (vazhdon)

c. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgaditur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do t'a ketë të nevojshme t'a ndërpresë aktivitetin e saj të paktën për 12 muaj pas datës së pasqyrave financiare (SKK 1/46-47).

d. Njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve

Në pasqyrat financiare, janë përfshirë zërat që plotësojnë përkufizimin e një aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi dhe që plotëson kriteret nëse: i. është e mundur që çdo përfitim ekonomik në të ardhmen lidhur me këtë zë, do të rrjedhë për ose nga njësia ekonomike; dhe ii. zëri ka një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.

e. Baza e matjes

Dy bazat e zakonshme të matjes janë kosto historike dhe vlera e drejtë:

- **Kosto historike**, për aktivet është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare të paguara ose vlera e drejtë e shumës së dhënë për të blerë aktivin në momentin e përftimit të tij. Për detyrimet është shuma e mjeteve monetare (apo ekuivalentëve të mjeteve monetare) ose vlera e drejtë e aktiveve jo-monetare të marra në këmbim për detyrimin në kohën e lindjes së këtij të fundit, ose në disa rrethana (për shembull, tatimi mbi të ardhurat) shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare që pritet të paguhet për të shlyer detyrimin në rrjedhën normale të biznesit.
- **Kostoja historike e amortizuar** është kostoja historike e një aktivi ose detyrimi plus ose minus atë pjesë të kostos së tij historike njohur më parë si shpenzim ose e ardhur.
- **Vlera e drejtë** është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do paguhej për të shlyer një detyrim, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.

f. Njohja dhe matja fillestare

Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, është bërë me koston historike, përveç rasteve kur SKK 1 kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë.

g. Vlerësimi i mëpasshëm

Aktivet dhe detyrimet financiare, maten me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm. SKK 3 përcakton si duhet të vlerësohen instrumentet financiare. Shumica e aktiveve jo-financiare të një njësie ekonomike që fillimisht njihen me kosto historike më pas maten mbi baza të tjera të matjes:

- aktivet afatgjata materiale me koston e amortizuar (ose vlerën e drejtë si një alternativë e lejuar në SKK 5 – Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale);
- inventarët me vlerën më të ulët mes kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot për të përfunduar shitjen;
- njeh një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me aktivet jo-financiare që janë në përdorim ose mbahen për shitje;

Shumica e detyrimeve, përveç detyrimeve financiare, maten me vlerësimin më të mirë të mundshëm të parashikuar që kërkohet për të shlyer detyrimin në datën e raportimit.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

2. Kuadri i përgjithshëm për përgaditjen e pasqyrave financiare (SKK 1) (vazhdon)

h. Kompensimi

Aktivet / detyrimet dhe të ardhurat / shpenzimet nuk kompensohen me njëra-tjetrën, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet ose lejohet nga një standard kombëtar i kontabilitetit.

i. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit *(kursi i publikuar nga BSH)*. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të dhënë monedhe (të huaj) në një monedhë tjetër (monedhën funksionale) me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivet dhe detyrimet jo - monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka), të cilat njihen në të ardhura të tjera përmbledhëse. Kurset kryesore të këmbimit LEKE/valute janë:

Monedha	31.12.2019	31.12.2018
USD	108.64	107.82
EUR	121.77	123.42

2.2. Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

a. **Kuptueshmëria,** Informacioni në pasqyrat financiare është paraqitur në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit për t'i kuptuar ato. Pasqyrave financiare janë të qarta e të kuptueshme edhe për përdorues të jashtëm, të cilët mund të mos jenë në dijeni të aktiviteteve të përditshme të njësisë ekonomike (SKK 1/67-69).

b. **Rëndësia dhe Materialiteti.** Pasqyrat financiare janë përgaditur mbi bazën e konceptit të materialitetit dhe bazuar në supozimet bazë, parimet dhe karakteristikat e informacionit kontabël. Në përcaktimin e materialitetit janë marrë parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit (SKK 1/70-76).

c. **Besueshmëria.** Informacioni i dhënë në pasqyrat financiare është i besueshëm dhe i lirë nga gabimet materiale.

d. **Parimi i paraqitjes me besnikëri.** Janë paraqitur me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera që rezultojnë në krijimin e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit për njësinë ekonomike në datën e raportimit dhe që plotësojnë kriteret e njohjes.

e. **Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.** Për regjistrimin e transaksioneve ekonomike në pasqyrat financiare është marrë në konsideratë përmbajtja e tyre ekonomike, e cila nuk është e thënë që të përputhet gjithmonë me formën e tyre ligjore.

f. **Parimi i paanshmërisë.** Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare, është i paanshëm, dhe i painfluencuar.

g. **Parimi i maturisë.** Parimi i kujdesit është përfshirja e një shkalle maturie në ushtrimin e gjykimeve të nevojshme në bërjen e vlerësimeve të kërkuara sipas kushteve të pasigurisë, të tilla që aktivet ose të ardhurat të mos mbivlerësohen dhe detyrimet ose shpenzimet të mos nënvlerësohen.

2.2. Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare (vazhdon)

Nuk është lejuar nënvlerësimi i qëllimshëm i aktiveve ose i të ardhurave, ose mbivlerësim i qëllimshëm i detyrimeve ose shpenzimeve.

h. **Parimi i plotësisë.** Pasqyrat financiare japin të gjithë informacionin e nevojshëm për të paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të mjeteve monetare të njësisë ekonomike.

i. **Qëndrueshmëria dhe krahasueshmëria,** Për përgatitjen e pasqyrave financiare janë përdorur vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formata të pasqyrave financiare (SKK 1/85-90).

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar ose duhen aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe. Ndryshimi në politikat kontabël zakonisht zbatohet në retrospektivë, d.m.th. sikur politika e re të ishte zbatuar gjithnjë. Informacioni krahasues i periudhave kontabël të mëparshme rishihet në mënyrë të tillë që ai të jetë i paraqitur në përputhje me politikën e re kontabël. Teprica e çeljes së fitimeve të pashpërndara rregullohet me qëllim që ajo të reflektojë ndryshimet për një ose më shumë periudha kontabël të mëparshme.

a) Investime në pjesëmarrje dhe në shoqëritë e kontrolluara (SKK 14)

Me vendimin e datë 5.10.2019 ortaku i vetëm i shoqërisë, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme ka vendosur të investojë për blerjen 100% të kuotave të shoqërisë "BE-IS ENERGY" SHPK e themeluar në zbatim të kontratës së konçensionit me Nr. 1656 Rep. Nr. 561/1 Kol datë 04.07.2016, të lidhur me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e autoritetit kontraktues për ndërtimin e hidrocentralit "Kalivar" në rrethin Pukë. Në zbatim të vendimit të ortakut të vetëm midis palëve (Shitës/blerës) është lidhur kontrata Nr. 5076 Rep. Nr. 2706 Kol. me datë 5 Tetor 2019. Investimi i parashikuar do të jetë 105, 000 EUR[1].Këto investime paraqiten në pasqyra financiare individuale të investitorit mbi bazën e modelit të kostos (në pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten sipas modelit të kapitalit). Ato njihen fillimisht me kosto, dhe më pas zhvlerësohen për të reflektuar vlerën e realizueshme të investimit. Humbja nga zhvlerësimi kalon në pasqyrën e performancës. Kosto e investimit përfshin të gjitha kostot e transaksionit. Investimet në pjesëmarrje klasifikohen si aktive afatgjata.

b) Instrumenta financiare (SKK 3)

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Detyrimi financiar (ose një pjesë të detyrimit financiar) çregjistrohet vetëm kur ai shuhet, (shlyhet, anulohet ose skadon). Instrumentat financiare joderivative përbëhen nga mjete monetare, depozita pa afat dhe depozita me afat fiks ku njësia ekonomike është depozituesi –letra tregtare dhe kambiale tregtare, hua të marra dhe të dhëna, llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme, etj. Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me çmimin plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Nëse një huadhënës dhe huamarrës ekzistues shkëmbejnë instrumente financiarë me kushte thelbësisht të ndryshme, njësitë duhet ta kontabilizojnë transaksionin si një shuarje të detyrimit fillestar financiar dhe njohjen e një detyrimi të ri financiar.

[1] Kontrata është në implementim e sipër në zbatim të nenit 12 pika 12.1.3 të kontratës së konçensionit...

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Politikat kontabël (vazhdon)

Në mënyrë të ngjashme, një njësi duhet të kontabilizojë një modifikim thelbësor të kushteve të një detyrimi financiar ekzistues ose një pjese të tij (pavarësisht nëse ky modifikim vjen ose jo si pasojë e vështirësive financiare të debitorit) si një shuarje e detyrimit financiar fillestar dhe njohjen e një detyrimi të ri financiar. Një njësi duhet të njohë në fitim ose humbje çdo diferencë mes vlerës kontabël të detyrimit financiar (ose pjesës së një detyrimi financiar) të shuar ose të transferuar tek një palë e tretë dhe shumën e paguar, duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar ose detyrime të marra përsipër.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Njohja e mjeteve monetare bëhet me vlerën e drejtë të parasë në datën e transaksionit. Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese, së bashku me një koment nga drejtuesit e saj, mbi shumën e mjeteve të konsiderueshme monetare dhe të gjendjeve të mbajtura nga njësia ekonomike, që nuk janë në përdorim nga njësia ekonomike. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mbajtura nga njësia ekonomike mund të mos jenë të disponueshme për përdorim nga njësia ekonomike për shkak, midis arsyeve të tjera, edhe të kontrolleve të këmbimeve valutore apo kufizimeve ligjore.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e paskontuar të mjeteve monetare të arkëtueshme nga ajo njësi, që është normalisht çmimi i faturës dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvleresimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna së shoqeria nuk do të jetë në gjëndje të mbledhe të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën paskontuar të mjeteve monetare të pagueshme, që është zakonisht çmimi i faturës dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huat e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën aktuale të mjeteve monetare të arkëtueshme ndaj dhënësit/ pagueshme ndaj bankës (duke përfshirë pagesat e interesit dhe të principalit). Pas njohjes fillestare, huat e marra dhe të dhëna afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar dhe me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv kur marrëveshja përbën transaksion financiar.

Kostoja, është

- vlera e drejtë e parasë ose e ekuivalenteve të saj të paguara ose vlera e drejtë e shpërblimeve të dhëna për të blerë një aktiv në kohën e blerjes ose të ndërtimit të tij
- shuma e parasë ose e ekuivalenteve të saj të arkëtuara ose vlera e drejtë e shpërblimeve të marra për të shitur një detyrim në kohën e shitjes ose likuidimit të tij.

3. Politikat kontabël (vazhdon)

Norma e interesit efektiv

Norma e interesit efektiv është norma me të cilën skontohen flukset e përllogaritura të ardhshme të parasë së një aktivi ose të një detyrimi financiar, në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha kostot e transaksioneve të paguara ose të marra, në lidhje me aktivin ose detyrimin financiar, si dhe të gjitha primet dhe zbritjet e tjera. Kur llogarit normën e interesit efektiv, njësia ekonomike duhet të parashikojë flukset e mjeteve monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (p.sh parapagimi) dhe humbjet e njohura financiare që kanë ndodhur, por ajo nuk duhet të marrë parasysh humbje të ardhshme të mundshme financiare që nuk kanë ndodhur ende.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

c) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shoqëria nuk operon me ndonjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas pensioni.

d) Aktive afatgjata materiale (SKK 5)

AAGJM janë në pronësi të shoqërisë. Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar *(vlerë neto)*. Kostoja perfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

(i) Njohja dhe matja

Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qellimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Kostot e huamarrjes trajtohen si shpenzime periudhe. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë gjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Pjesët kryesore të këmbimit dhe pajisjet rezervë janë aktive afatgjata materiale kur një njësi ekonomike pret për t'i përdorur ato gjatë më shumë se një periudhe. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se pjesët e këmbimit, instrumentat dhe veglat e punës mund të përdoren vetëm në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale, ato konsiderohen si aktive afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabël (vazhdon)

d) Aktivet afatgjata materiale (vazhdon)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e vënies në punë. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Aktivi	N/A
Ndërtesa - mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri e pajisje- mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete transporti - mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi - mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike - mbi vlerën kontabël neto	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur duhet të rishikohen në çdo datë raportimi.

e) Aktive të qendrueshme jomateriale

Aktivet e qëndrueshme jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvleresimi *(vlerë neto)*. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë zbritëse përgjate jetës së aktivit. .

f) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojne se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshmë që parashikohet të burojne nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diference midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime. Një humbje nga zhvleresimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Politikat kontabël (vazhdon)

(ii) *Aktivet jofinanciare*

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëhere vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve.

g) Administrimi i riskut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huatë dhe detyrime të tjera.

(i) Risku i kredisë

Risku i mos - pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arkëtueshme. Maksimumi i riskut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Risku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve.

(ii) Risku i likuiditetit

Shoqëria duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktiviteti i saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria administron rrezikun kryesisht përmes mbështetjes së financimit afatshkurtër dhe afatgjatë.

(iii) Risku i tregut

Risku i normave të interesit

Ekspozimi kryesor i Shoqërisë ndaj riskut të normave të interesit lidhet me huatë që mbartin interes. Drejtuesit nuk kanë hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky risk.

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me huatë në USD, EUR. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 Dhjetor 2019.

h) Inventari (SKK 4)

Inventarët, në njohjen fillestare maten me kosto dhe me pas maten me shumën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit ose shndërrimit dhe kosto të tjera të nevojshme për sjelljen e tyre në vendndodhjen dhe kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe realizimin e shitjes.

3. Politikat kontabël (vazhdon)

i) Provigjonet (SKK 6)

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Shuma e njohur si provizion do të jetë vlerësimi më i saktë i mundshëm i shpenzimeve të nevojshme për shlyerjen e një detyrimi ekzistues të mundshëm, e vlerësuar kjo në datën e raportimit. Një njësi ekonomike do t'i rishikojë provizionet në çdo datë të raportimit dhe do t'i rregullojë ato për të pasqyruar vlerësimin më të mirë aktual të shumës që do të kërkohet për të shlyer detyrimin në atë datë të raportimit.

j) Njohja e të ardhurave (SKK 8)

Shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë rrjedhës normale të biznesit matën me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke zbritur kthimet e mundshme të mallrave, zbritjet tregtare dhe rabatet. Të ardhurat njihen atëhere kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme janë transferuar tek blerësi, marrja e shërbimit është e sigurtë, kostot përkatëse si dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të vlerësohen në menyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të shitësit në menaxhimin e mallrave, si dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri.

Shitja e shërbimeve

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

k) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijne të ardhura interesi dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e performancës. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Fitim/(humbja) nga ndryshimi i kursit të këmbimit që krijohet gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin. Kur një transaksion shlyhet në një periudhë kontabël të mëpasshme, diferenca e këmbimit, e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës nga periudhat kontabël.

l) Tatimi mbi fitimin (SKK 11)

Tatimi mbi fitimin e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Gjatë vitit ushtrimor tatimi mbi fitimin paguhet paradhënie sipas detyrimit të planifikuar nga organet tatimore bazuar në legjislacionin shqiptar. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 është 15% (2018:15%). Deklaratat tatimore përfundimtare e tatimit mbi fitimin e vitit të mbyllur dorëzohen deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qellime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Politikat kontabël (vazhdon)

Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Tatimi i shtyrë njihet për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet bazuar në metodën e realizimit ose kompensimit të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

m) Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka çështje apo pretendime që do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka angazhuar kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

4. Korigjimi i gabimeve

Gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Gabime të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimeve në zbatimin e politikave kontabël, paqartësitë apo keqinterpretimet e fakteve, dhe mashtrimet.
Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme do të korrigjohen, sipas njërës prej dy mënyrave të mëposhtme:

1) Në retrospektivë, që do të thotë se shuma e korrigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke rregulluar tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara. Informacioni krahasues duhet të riparaqitet, nëse është praktikisht e mundshme; ose
2) Duke ri-paraqitur tepricat e çeljeve për aktivet, detyrimet dhe kapitalin e periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur, në rastet kur gabimi ka ndodhur përpara periudhës më të hershme të paraqitur. Gabimet jomateriale duhet të korrigjohen në periudhën kontabël aktuale. Korrigjimi i gabimeve jomateriale në retrospektivë nuk lejohet.

5. Shpjegime mbi palët e lidhura (SKK 2/91-94)

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka investuar në palët e treta[2]. Nuk janë bërë transaksione me ortakun si palë e lidhur me shoqërinë.

6. Ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese (SKK 1/116-118)

Nuk ka asnjë ngjarje të ndodhura pas mbylljes së periudhës raportuese, apo para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, që kërkojnë korrigjim të shumave të njohura në pasqyrat financiare apo përshkrim në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për ngjarjet e ndodhura pas publikimit tyre, nëse ato janë materiale..

[2] Shih shënimin Nr. 3.a më sipër

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

7. Deklarimi i dividendëve pas përfundimit të periudhës raportuese

Nëse një njësi ekonomike u deklaron dividendët mbajtësve të instrumentave të kapitalit neto të saj pas përfundimit të periudhës raportuese, njësia ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si një detyrim në fund të periudhës raportuese. Shuma e dividendit mund të paraqitet si një komponent i ndarë nga fitimet e pashpërndara në fund të periudhës raportuese.

8. Analiza e posteve të pasqyrës së pozicionit financiar (bilancit)

8.1. Aktivet afatshkurtra

8.1.1. Mjete monetare

Gjëndja e MM për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Banka	108,888,337	255,594,619
Arka	1,651,887	483,132
Totali	**110,540,224**	**256,077,751**

8.1.1.1. Gjëndjet e aktiveve monetare

Llogaria	LEKE	*$USD*	LEKE	*€EURO*	LEKE	Totali/LEKE
BKT	36,449,751	*4,002.38*	434,819	*1,458.51*	177,603	37,062,173
CREDINS	56,507,147	-	-	*103,344.15*	12,584,217	69,091,364
ISP	-	-	-	*22,458.73*	2,734,800	2734800
Total 2019	**92,956,898**	***4,002.38***	**434,819**	***127,261.39***	**15,496,620**	**108.888,337**
Total 2018	**249,784,720**	***5,409.40***	**583,241**	***42,348.55***	**5,226,658**	**255,594,619**

8.1.2. Të drejta të arkëtueshme

Gjëndja e të drejtave të arkëtueshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Klientë të arkëtueshëm	**216,933,053**	**92,310,181**
Të tjera të arkëtueshme	1,893,110	4,790,534
Tatim mbi fitimin	-	9,296,350
TVSH	-	8,334,663
Detyrime doganore	-	9,837
Të tjera - Hua ASH	12,400,000	-
Tw tjera tw arkwtueshme nw total	**14,293,110**	**22,431,384**
Totali	**231,226,163**	**114,741,565**

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.1.3. Inventarët

Gjëndja inventarëve për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Materiale të para	14,240,619	50,855,822
Materiale të tjera	-	4,885,376
Totali	**14,240,619**	**55,741,198**

8.2. Aktive afatgjata

8.2.1. Aktivet financiare

Gjëndja e aktiveve afatgjata financiare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Investime financiare për blerje kuotash	12,260,000	-
Depozita bankare AGJ	150,000,000	-
Totali	**162,260,000**	**-**

8.2.2. Aktive afatgjata materiale

Gjëndja e aktiveve afatgjata materiale për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Toka, troje, terrene	30,329,300	30,329,300
Ndërtime e sheshe industriale në pronësi	6,195,336	6,521,406
Ndërtime e sheshe industriale	208,477,621	219,450,127
Ndërtime të vitit (në ekonomi)	4,518,355	-
Instalime teknike e makineri	377,775	434,099
Mjete transporti	6,772,714	4,934,198
Mobilje e orendi e paisje zyre	1,883,200	782,719
Paisje informatike e kompjutera	451,441	509,497
Totali	**259,005,742**	**262,961,346**

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.2.2.1. Gjëndja dhe lëvizja e aktiveve AGJM dhe amortizimit

Përshkrimi	Toka e troje	Ndërtime - industriale	Ndërtime e sheshe	Ndërtime të vitit	Inst. Mak. paisje	Mjete trasporti	Mobilje e paisje zyre	Paisje Inform. e kompju.	Totali
Kosto									
Në 1 Janar 2019	**30,329,300**	**229,991,400**	**6,988,013**	**-**	**542,624**	**6,599,917**	**1,058,948**	**862,160**	**276,372,362**
Blerë e krijuar		-	-	4,518,355	35,392	3,089,946	1,387,041	72,333	9,103,067
Paksime	-	-	-		-	-	-	-	-
Bilanci 31 .12. 2019	**30,329,300**	**229,991,400**	**6,988,013**	**4,518,355**	**578,016**	**9,689,863**	**2,445,989**	**934,493**	**285,475,429**
Amortizimi									
Në 1 Janar 2019	**-**	**10,541,273**	**466,607**	**-**	**108,525**	**1,665,719**	**276,229**	**352,663**	**13,411,016**
Llogaritur për vitin	-	10,972,506	326,070	-	91,716	1,251,430	286,560	130,389	13,058,671
Amortizimi i AAGJM të dala	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bilanci 31.12.2019	**-**	**21,513,779**	**792,677**	**-**	**200,241**	**2,917,149**	**562,789**	**483,052**	**26,469,687**
Vlera neto e librit									
Në 31 Dhjetor 2019	**30,329,300**	**208,477,621**	**6,195,336**	**4,518,355**	**377,775**	**6,772,714**	**1,883,200**	**451,441**	**259,005,742**
Në 31 Dhjetor 2018	**30,329,300**	**219,450,127**	**6,521,406**	**-**	**434,099**	**4,934,198**	**782,719**	**509,497**	**262,961,346**

8.2.3. Aktive tatimore të shtyra

Shoqëria nuk ka aktiv tatimor të shtyrë për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019.

8.3. Detyrime afatshkurtra

8.3.1. Titujt e huamarrjes

Gjëndja e huamarrjes afatshkurtër që nuk mbart interesa për periudhën që përfundon më 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon

Llogaria	**31 Dhjetor 2019**	**31 Dhjetor 2018**
Hua që nuk mbart interesa	-	6,788,100
Totali	**-**	**6,788,100**

8.3.2. Detyrime afatshkurtra tregtare

Gjëndja e detyrimeve afatshkurtra tregtare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj furnitorëve	**178,751,969**	**142,376,805**
Punonjësit - paga	4,602,401	1,271,768
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	418,598	191,654
Total paga dhe sigurime	**5,020,999**	**1,463,422**
Tatim mbi pagat	57,603	10,075
Tatim fitimi	3,882,339	-
TVSH	1,546,975	-
Tatim në burim	106,500	106,500
Total detyrime tatimore	**5,593,417**	**116,575**
Ortakë - llogari rrjedhëse	7,926,880	-
Ortakë - dividend	152,474,914	7,926,880
N/Totali 1	**160,401,794**	**7,926,880**
Të ardhura të shtyra nga paradhëniet[3]	-	**1,667,958**
Totali	**349,768,179**	**153,551,640**

8.4. Detyrime afatgjata

8.4.1. Titujt e huamarrjes

Shoqëria nuk ka huamarrje afatgjata për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019

8.4.2. Detyrime të pagueshme

Gjëndja e detyrimeve afatgjata në përdorim që nuk mbartin interesa për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Ortakë	229,991,400	229,991,400
Totali	**229,991,400**	**229,991,400**

[3] Vlera e paradhënies 1 667 958 të ardhura të shtyra nga 2018 sipas ligjit për TVSh, është mbyllur gjatë 2019. Kjo vlerë eshtë diferenca plus në të ardhurat në krahasim me FDP

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.5. Kapitali dhe rezervat

Gjëndja e kapitalit dhe rezervave për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Kapital i nënshkruar i paguar	65,100,000	100,000
Rezerva ligjore	10,000	10,000
Rezerva të tjera	68,347,118	278,733,602
Fitimi i pashpërndarë	-	-
Fitim/ (humbja) e vitit	64,056,051	20,347,118
Totali	**197,513,169**	**299,190,720**

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.5.1. Gjendja dhe ndryshimi i kapitalit

Struktura	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva rivleresimi	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e pashpërndara	Fitim /(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2017	**100,000**	-	-	**10,000**	**95,038,845**	-	**183,694,757**	**278,843,602**
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiari rideklaruar më 01 Janar 2018	**100,000**	-	-	**10,000**	**95,038,845**	-	**183,694,757**	**278,843,602**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:								
Fitim/(humbja) e vitit	-	-	-	-	-	-	20,347,117	20, 347,117
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-	-	**20,347,117**	**20, 347,117**
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:								
Emetim i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-	-
Mbulimi i humbjes	-	-	-	-	-	-	-	-
Përdorimi I fitimit të pashpërndarë	-	-	-	-	183,694,757		(183,694,757)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	**183,694,757**		**(183,694,757)**	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 Dhjetor 2018	**100,000**	-	-	**10,000**	**278,733,602**	-	**20,347,117**	**299,190,719**

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.5.1. Gjendja dhe ndryshimi i kapitalit (vazhdon)

Struktura	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva rivleresimi	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e pashpërndara	Fitim /(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 01 Janar 2019	**100,000**	**-**	**-**	**10,000**	**278,733,602**	**-**	**20,347,117**	**299,190,719**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:								
Fitim/(humbja) e vitit	-	-	-	-	-	-	64,056,051	64,056,051
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**64,056,051**	**64,056,051**
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:								
Emetim i kapitalit të nënshkruar	65,000,000	-	-	-	(65,000,000)	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	(165,733,602)	-	(165,733,602)
Kalimi I rezervave të disponueshme në fitimie të pashpërndarë					(165,733,602)	165,733,602		
Përdorimi I fitimit të pashpërndarë	-	-	-	-	20,347,118	-	(20,347,118)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	**65,000,000**	**-**	**-**	**-**	**(210,386,484)**	**-**	**(20,347,118)**	**165,733,602**
Pozicioni financiarr më 31 Dhjetor 2019	**65,100,000**	**-**	**-**	**10,000**	**68,347,118**	**-**	**64,056,051**	**197,513,169**

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9. Pasqyra performancës (PASH)

Paraqitja e PASH është bërë duke i klasifikuar sipas natyrës

9.1. Të ardhurat

9.1.1. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga Shërbimi	257,545,632	146,890,236
Të ardhura nga shërbime tjera - konsulenca	31,849,227	19,552,498
Të ardhura nga shitja e materialeve	65,910,591	10,993,976
Totali	**355,305,450**	**177,436,710**

9.1.2. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Gjatë vitit 2019, Shoqëria ka realizuar 4 518 355 LEKE të ardhura të tjera nga prodhimi i AAGJM.

9.2. Shpenzimet

9.2.1. Shpenzime për lëndë të parë e materiale të konsumueshme

Shpenzimet për aktivitetin e shfrytëzimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Blerje/Shpenzime materiale	144,314,017	118,951,374
Blerje/Shpenzime materiale të pastokueshme	965,922	106,561
N/Totali 1 - materiale	**145,279,939**	**119,057,935**
Blerje/shpenzime ujë e energji	5,032,357	6,959,312
Totali	**150,312,296**	**126,017,247**

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9.2.2. Të tjera shpenzime shërbimi të shfrytëzimit

Shpenzimet për lëndë të para e materiale të konsumueshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime për qira	8,748,852	10,185,000
Shpenzime për mirmbajtje e riparime	503,582	3,802,039
Shpenzime për prime sigurimi	120,883	215,177
Shpenzime për blerje e shërbime të tjera	818,731	834,678
Shpenzime për shërbime me nënkontraktorë	78,894,756	-
Shpenzime për honorare për shërbime nga P_3	2,132,500	1,663,740
Shpenzime për udhëtime e dieta	3,337,207	3,856,359
Shpenzime postare	61,003	-
Shpenzime për shërbime bankare	185,297	160,301
Shpenzime për taksa vendore	2,151,685	686,689
Subvencione për tërmetin	100,000	-
Shpenzime për pritje e inagurime	-	3,750
Totali	**97,054,496**	**21,407,733**

9.2.3. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Pagat e personelit	16,416,256	8,185,400
Shpenzimet për sigurime shoq. e shëndet	2,762,989	1,378,774
Totali	**19,179,245**	**9,564,174**

9.2.4. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Amortizimi i AAGJM	13,058,671	2,033,903
Totali	**13,058,671**	**2,033,903**

9.2.5. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Shpenzimet e zhvlerësimit të AAGJM për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 nuk ka.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9.2.6. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Gjëndja shpenzimeve të tjera të shfrytëzimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime për gjoba e penalitete	2,462,211	97,973
Të tjera të panjohura – vlerësime tatimore	2,016,576	-
Totali	**4,478,787**	**97,973**

9.2.7. Shpenzime financiare

Rezultati financiar për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat bankare	794,366	2,112
Shpenzime për interesa bankare	(9,847)	-
Fitime nga kursi i këmbimit	166,089	6,245,934
Humbjet nga kursi i këmbimit	(540,484)	(608,651)
Totali	**410,124**	**5,639,395**

10. Rezultati tatimor

Rezultati tatimor për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 paraqitet si vijon:

Rezultati tatimor	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fitim/(humbja) para tatimit	**76,150,434**	**23,955,075**
Shpenzime të pazbritshme:	**4,478,787**	**97,973**
Gjoba e penalitete	*2,462,211*	*97,973*
Të tjera të panjohura	*2,016,576*	-
Fitimi tatimor	**80,629,221**	**24,053,048**
Humbje e mbartur	-	-
Fitimi i tatueshem	**80,629,221**	**24,053,048**
Tatim/ fitimin	12,094,383	3,607,957
Fitimi pas tatimit	**64,056,051**	**20,347,118**

Data 30 Mars 2020

Jeda REXHA
Financier

Ilir TABAKU
Administrator